



VENDIM

Nr. 70 Datë 06.10.2010

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 45, DATË 30.07.2007 “PËR
MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT MBI
BASHKËPUNIMIN NDËRMJET ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHQIPËRISË DHE
ENTIT RREGULLATOR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
TË TURQISË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma “gj” dhe nenit 9 të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar si dhe neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës __.10.2010, pasi shqyrtoi ndryshimet e propozuara për Memorandumin e mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Enteve Rregullatore të Energjisë Elektrike të Shqipërisë, dhe Turqisë,

Vendosi:

1. Të bëjë ndryshimet e Memorandumit të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Entit Rregullator të Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Entit Rregullator të Tregut të Energjisë Elektrike të Turqisë. (Memorandumi me ndryshimet përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet kryetari i ERE-s të nënshkruajë për ERE-n këtë Memorandum Mirëkuptimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë për ndjekjen e zbatimit të këtij Memorandumi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE-s

Bujar NEPRAVISHTA